



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:072832
Datë: 16.02.2024
Numri i dokumentit: 05342462

Ka. nr. 53/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurës Subjektit Ekonomik – si person juridik “Petroll Company”, SHPK, me Drejtorë Shkelzen Hysaj, me NRB: 810527195, me adresë Prishtinë – Fushë Kosovë – Prishtinë, për kundërvajtje nga neni 15 par. 3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.1 si dhe për kundërvajtje nga neni 9 par. 2 pika 1.2 lidhur me nenin 26 të sanksionuar me nenin 137 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga e pandehura Subjekti Ekonomik – si Person juridik “Petroll Company”, SHPK përmes Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” sipas autorizimit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K. nr. 1507/2022, të datës 10.01.2024, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe neni 78, konform të nenit 143 par. 1 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga e pandehura Subjekti Ekonomik – si Person juridik “Petroll Company”, SHPK, me adresë Prishtinë – Fushë Kosovë – Prishtinë, sipas autorizimit, ndërsa **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 1507/2022, i datës 10.01.2024, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut me Nr. INS - me numër të protokollit 2164, të datës 04.04.2022, me aktgjykim K. nr. 1507/2022, të datës 10.01.2024, të pandehurën subjektin ekonomik si person juridik “Petroll Company”, SHPK, me Drejtorë Shkelzen Hysaj, me adresë Prishtinë – Fushë Kosovë – Prishtinë, e ka shpall përgjegjëse sepse:

- Sepse me datën 30.03.2022, rrethe orës 10:30min, gjatë inspektimit nga Inspektorët Eljesa Beqiri, Inspektore te Tregut në MINT, si dhe në bashkëpunim me Inspektorët e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), në bazë procesverbalit me nr. 19/00558, të datës 30.03.2022, të Subjekti Ekonomik “Petroll Company” Sh.p.k me numër NUI: 810527195, me adresë me adresë Magjistralen Prishtinë - Fushë Kosovë në Prishtinë, e cila merret me veprimtarin e shitjes me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës, lidhur me verifikimin e marzhës tregtare të derivateve të përcaktuar me Vendim me Nr. 02/66 të datës 01.03.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në Procesverbalin me Nr. 19/00558, të datës 30.08.2022, dhe Raportit të Inspektorëve të Administratës Tatimore (ATK) të datës 01.04.2022, me ç rast Subjekti Ekonomik “Petroll Company” Sh.p.k, me numër NUI: 810527195, me adresë Magjistralen Prishtinë - Fushë Kosovë në Prishtinë, e ka tejkaluar marzhën tregtare të përcaktuar me Vendim Nr.02/06 të datës 01.03.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 15 par. 3 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate te Naftës në Kosovë, ndërlidhur me nenin 9 par. 2 pika 1.2, lidhur me nenin 26 par. 1 të Ligjit për Mbrojtën e Konsumatorit me Nr. /L-034, që dënohet në bazë të nenin 19 par. 13, nën par. 13.1 të ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivate te Naftës në Kosovë, të ligjit Nr.08/L-018, me aplikim të nenit 35 par. 1, të Ligjit Për Kundërvajtje të Republikës së Kosovës i ka shqiptuar dënim me **gjobë në shumën prej 4000(katërmijë)€**, është obliguar e pandehura që gjobën e shqiptuar të paguan në afat prej **15 ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në xhirollogari të Këshillit Gjyqësor **No.1000 4300 7000 0518**, po ashtu i pandehuri obligohet që në afat të lartcekur të paguaj **10 (dhjetë)€**, në emër të paushallit gjyqësor, nëse e pandehura nuk e bënë pagesën në afatin e parapara me ligj do të bëhet ekzekutimi sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë e pandehura Subjekti Ekonomik – si Person juridik “Petroll Company”, SHPK përmes Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, sipas autorizimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të Ligjit material, me të cilën është paraparë kundërvajtja, në të cilën veç të tjerash thekson se: inspektimi është bërë me qëllim të verifikimit të respektimit të marzhës tregtare të derivateve të përcaktuara me Vendim të Qeverisë Nr. 02/66 të datës 01.03.2022, për periudhën 21.03.2023 deri 30.03.2022, në ç rast në mënyrë krejt të gabuar kanë ardhur në përfundim se e pandehura e ka kaluar marzhën tregtare të përcaktuar me Vendim të Qeverisë. Gjykata e shkallë së parë ka nxjerr aktgjykim me një gjendje të vërtetuar gabim andaj konsiderojnë se aktgjykimi është i padrejtë në ç rast është bërë edhe aplikimi i gabuar i së drejtës materiale, me datë 12.03.2023 ka hyr në fuqi Ligji Nr. 08/L-018 për tregti me Naftë dhe karburante të ripërtrishme dhe i ka shfuqizuar ligjet e më hershme në ç rast vendimi i të Qeverisë Nr. 02/66 të datës 01.03.2022, është nxjerr duke u bazuar në dispozitat e ligjit Nr. 2004/05 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë i cili ka qenë i shfuqizuar, andaj është nxjerr me aplikim të gabuar të ligjit material. Ligji i ri Nr. 08/L-018 në nenin 21 qartë ka rregulluar se: 1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) muajsh, Qeveria dhe Ministri nxjerr aktet nënligjore. 2. Për aq sa nuk janë në kundërshtim me këtë ligj, zbatohen deri kur të zëvendësohen këto akte nënligjore: 2.1. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës; 2.2. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2018 për përcaktimin e procedurës së licencimit për subjektet që ushtrojnë veprimtari në sektorin e naftës; 2.3. Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2010 për përmbushjen e kushteve teknike nga subjektet që merren me importin, deponimin, shitjen me shumicë dhe pakicë të karburanteve; 2.4. Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2010 për caktimin e lartësisë së taksave për licencimin e subjekteve nga sektori i naftës dhe derivateve të naftës; 2.5. Udhëzimi Administrativ Nr. 2007/18 për kërkesat teknike për ndërtimin dhe funksionimin e pikave për furnizimin e automjeteve me karburante. Andaj konsideroj se ndëshkimi i pandehurës me një Akt nën ligjor i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën kur pretendohet se është ndërmarr veprimi kundërvajtës, gjykata e ka zbatuar gabim ligjin material me të cilin është paraparë kundërvajtja. Po ashtu me datë 25.06.2022 ka hyr në fuqi UA Nr. 03/2022 për rregullimin e çmimeve të produkteve të

naftës dhe masat mbrojtëse, vetëm me këtë rregullore është paraparë marzha tregtare maksimale dhe mënyra e llogaritjes së kësaj marzhe. E pandehura nuk është përgjegjëse për kryerjen e asnjë veprimi kundërvajtës, Neni 139 par. 1 pika. 9 e LK-së, përcakton se: 1.9. dispozitivi i vendimit është i pakuptueshëm, kundërthënës me vet veten apo me arsyet e vendimit apo vendimi nuk përmban arsyet apo në te nuk janë theksuar arsyet për faktet vendimtare apo ato arsye plotësisht janë të pakuptueshme apo në masë të dukshme janë kundërthënëse. Pra gjykata e shkallë së parë fare nuk e ka sqaruar se në cilën ditë është tejkaluar marzha apo sa ashtë tejkalimi i marzhës por ka lënë të kuptohet sipas raportit të ATK-së, se e ka kaluar marzhën në secilën ditë e cila i është nënshtruar kontrollit. Madje gjykata nuk e ka marr parasysh se shitjet me shumicë nuk kanë në asnjë ditë tejkalim të marzhës.

I propozon Gjykatës se Apelit - Divizioni i Kundërvajtës, që ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e goditur ta Ndryshoj duke e liruar të pandehurën në mungesë të provave ose ta Anulon dhe lëndën ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Kolegji i Gjykatë së Apelit vlerësoj thëniet në ankesën e paraqitur, aktgjykimin e goditur, si dhe shkesat tjera të lëndës dhe konstatoj se ankesa e ushtruar është e pa bazuar dhe refuzohet aktgjykimi i goditur vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, në bazë të deklaratës së Përfaqësuesit Urim Voksh, avokat nga Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” sipas autorizimit, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësore pranë gjykatës së shkallës së parë, në Procesverbal të datës 07.12.2023, në ç rast si Përfaqësues i së pandehurës ka deklaruar se në tërësi e kundërshtojnë Kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, pasi që subjekti ekonomik nuk ka bërë kurrfarë veprimi kundërvajtës, në bazë të Procesverbalit të datës 01.04.2023, mbi dëgjimin e Inspektorit të Tregut të MINT-së, Eljesa Beqiri, e cila ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesës pasi që në rastin konkret ekziston Raporti i përpiluar të Inspektorëve të ATK-së, i cili ka vërtetuar se subjekti ekonomik e ka tejkaluar marzhën e përcaktuar sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, në bazë të formës për Vizitat Përmbushëse, Nr.95/4022 të datës 21.04.2022 - Raporti i bërë nga ATK-së, të gjeturat gjatë verifikimit të çmimit të shitjes (marzha e fitimit) duke i krahasuar çmimet e blerjes me çmimet e shitjes me pakicë prej datës 12.03.2022 deri 30.03.2022, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/66 i datës 01.03.2022, si dhe nga shkresat tjera të lëndës, pa dyshim se gjykata e shkallës së parë, e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 15 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.1 si dhe kundërvajtje nga neni 26 të Ligjit Nr. 06/L-034, sanksionuar me nenin 137 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse, andaj në këtë drejtim nuk ka bazë për ndryshimin apo anulimin e aktgjykimin të goditur, ashtu si që pretendohet në ankesë.

Kolegji aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe në këtë aspekt gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje nga neni 139 të LK-së, e të cilat detyrimisht do ta kishim kushtëzuar prishjen e aktgjykimin.

Kolegji, konstatoi se aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë, konkret, përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje kundërvajtëse dhe në arsyetimin e aktgjykimin të kundërshtuar e ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar si dhe ka dhënë arsyet e qarta për vërtetimin e tillë të fakteve, po ashtu Kolegji i kësaj gjykate i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të cekura në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi se janë të pa bazuara, të pa qëndrueshme si dhe pa ndikim sepse në shkresa të lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plot dhe të drejtë.

Kolegji i gjykatës së shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të butë ndaj të pandehurës.

Kolegji vlerësoj se gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kurse gjoba e shqiptuar ndaj të pandehurit, në shumë prej 4000€, konsiderohet se është caktuar sipas shkallës së përgjegjësisë dhe është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës kundërvajtëse dhe shkallën e përgjegjësisë dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 2 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ka. nr. 53/2024, me datë 13.02.2024,



KRYETARJA E KOLEGJIT,
Azra Cakolli